

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-188/11

**Prishtinë,
17 prill 2013**

Në çështjen juridike të

M. L.

Beograd, Serbi

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, gjyqtarë, në lidhje me kërkesën e paraqitësit të kërkesës lidhur me vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/32/2008 (lënda është regjistruar në AKP me numrin KPA08391), të datës 19 dhjetor 2008, pas shqyrtimit të mbajtur me 17 prill 2013, mori këtë

AKTVENDIM

Lënda i kthehet KKPK-së pasi që ankesa sipas meritave të saj është kërkesë për korrigjim tekstual në vendimin e Komisionit.

Përmbledhja e çështjeve faktike dhe procedurale:

Më 5 janar 2007, M. L. ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës, ku ka kërkuar kthimin në posedim të një prone që ndodhet në Pejë – të një shtëpie prej 80 m² dhe ngastrës 516/14. Ndërtesa ndodhet në ngastrën në fjalë. Kërkesa është regjistruar në AKP me numrin KPA08391.

Kërkesa është miratuar më vendimin KPCC/D/R/32/2008 (lënda është regjistruar në AKP me numrin KPA08391), të datës 19 dhjetor 2008, i cili e ka përshkruar pronën si ngastra 516/14 me sipërfaqe prej 80 m². Paraqitësi i kërkesës, tani pala ankuuese ka paraqitur ankesë duke cekur se vendimi është i gabuar sa i përket sipërfaqes së shtëpisë prej 80 m², sepse sipërfaqja është 453 m², që arrin në 533 m².

Kolegji i Apelit të AKP-së ka kërkuar nga KKPK-ja që të përgjigjet nëse ka pasur një gabim shkrimi – në urdhrin e gjykatës të datës 17 prill 2012.

Më pastaj është nxjerrë një vendim i korrigjuar individual me datën 14 maj 2012, i cili e ka përshkruar pronën si një shtëpi prej 89 m² dhe si ngastër prej 3 ari e 33 m² (apo 433 m²).

Me urdhrin e ri, të datës 11 shtator 2012, gjykata përsëri ka kërkuar nga KKPK-ja që të sqarojë nëse ka ndonjë gabim shkrimi në vendimin e ri individual dhe nëse sipërfaqja e ngastrës është 4 ari e 33 m² apo 4 ari e 53 m².

Me vendimin e ri të korrigjuar të datës 1 nëntor 2012, prona është përshkruar saktësisht si “ngastra numër 516/14, një shtëpi me sipërfaqe prej 80 m² dhe tokë ngjitur me të me sipërfaqe prej 4 ari e 53 m²”.

Kështu që, gabimi në shkrim në vendimin origjinal ishte korrigjuar.

Arsyetim ligjor

Lënda i kthehet KKPK-së pa një vendim mbi ankesën pasi që kjo e fundit në fakt paraqet një kërkesë për korrigjimin e gabimit në shkrim, kështu që KKPK-ja tashmë e ka korrigjuar gabimin vetë në përputhje me nenin 8.9 të Shtojcës III së Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079. Depozita në fjalë përshkruan se *“Çfarëdo gabimesh tekstuale në vendim të Komisionit, të cilët nuk ndikojnë materialisht në të drejtat e cilësdo pale, mund të korrigjohen nga zyrtari i lartë i caktuar nga Komisioni ose nga drejtori i Sekretariatit ekzekutiv, pas marrjes së pëlqimit të qartë me shkrim të kryesuesit të Komisionit”*.

Siç është cekur korrigjimi është e drejtë e vetë Komisionit dhe ai tashmë e ka bërë këtë.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it